



Autor: Gen Kelmendi

Në konferencën "Albanian Neighborhood" të mbajtur më 9 korrik 2012, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në fjalimin e tij duke folur për Bashkimin Kombëtar, shpallosi edhe bindjet e tija ateiste dhe komuniste.

Ai ndër të tjera tha:

**"Shqiptaria si fe e shqiptarëve",**

**"Shtetet shqiptare duhet të jenë kish dhe xhami për shqiptarinë"...**

Albin Kurti e përdorë nacionalizmin si armë kundër Islamit. Dhe siç tregon vet në fjalimin e tij, ky e nxiti Ali Ahmetin që me nacionalizëm të zhduki Islamin në Maqedoni. Ai thotë:

**"Mbrëmë, derisa bisedoja me z. Ali Ahmeti, i theksova tri gjëra të nevojshme për shqiptarët jashtë Shqipërisë e Kosovës dhe subjektet e tyre politike: 1) Të jenë radikalë brenda institucioneve, por edhe të bëjnë aktivitete jashtë institucionale të pa dhunshme; 2) Kombi si formacion socio-historik modern duhet të forcohet sepse ai është, përveçse vlerë, edhe armë e fuqishme që na ka emancipuar edhe kundrejt feudalizmit, edhe kundrejt religjionit".**

Ky me këtë bindje të tillë del të jetë i pa fe, pa identitet fetar, ndërsa muslimanët ende e pasojnë këtë njeri ?

Kjo është edhe një argument tjetër për ata të cilët e pasojnë dhe që votuan për të, ngase ky përveç që ka bindje ateiste-komuniste, ky dëshiron që mbi frymën e patriotizmit të marr pushtetin demokratikë,

Mos të harrojmë se me datë 29 Gusht 2011, kur në Parlamentin e Republikës së Kosovës po mbahej seanca e rregullt, dhe ku diskutohej për amendamentet të cilat përcaktojnë lejimin e bartjes së shamisë në shkollat publike dhe për futjen e edukatës fetare në shkollat publike, Lëvizja VETËVENDOSJE lëshon sallën, gjë që nënkupton se ata nuk deshën të bëhen pjesë e akuzave të muslimanve, ngase po të ishin në sallë ata detyrimisht do të votonin kundër. Pra, edhe nga kjo situatë Lëvizja Vetëvendosje u mundua të përfitojë poenë politik.

Pra, ky është ai cili publikon haptas bindjen e tijë ateiste-komuniste, ndërsa ty si besimtarë, çfarë të lidhë me të ?!

Fjalimin e plotë mund ta gjeni këtu: <http://www.youtube.com/watch?v=FAWt-uxkFM>

*Autori është student në Fakultetin Juridik*